



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:129362
Datë: 12.12.2022
Numri i dokumentit: 03738992

PPP.1021/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Përmbarimore, gjyqtari Betim Behluli si dhe më Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të përmbarimit të kreditorit, A. (Z.) P. nga Prishtina, kundër debitorit Sh. (S.) K. nga fshati Mleqan, Komuna e Malishevës, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.667/21 datës 03.06.2021, jashtë seancës gjyqësore, me datë 12.12.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar** prapësimi i debitorit Sh. (S.) K. nga fshati Mleqan, Komuna e Malishevës i datës 27.05.2022 i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.667/21 datës 03.06.2021 të me të cilin është lejuar përmbarimi në këtë çështje juridike të përmbarimit.
- II. MBETET në fuqi** Urdhri Përmbarimor P.nr.667/21 datës 03.06.2021 për lejimin e përmbarimit në këtë çështje përmbarimore për detyrimin në shumën prej 2,050.00 euro, si dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

A r s y e t i m

Kreditori A. (Z.) P. nga Prishtina me datë 03.06.2021 në zyrën e Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, si organ kompetent përmbarues ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të titullit përmbarimore aktit noterial- Kontratën e Shitblerjës së Automjetit LRP.nr.1323/2020 Ref: 2359/2020, ndaj debitorit Sh. (S.) K. nga fshati Mleqan, Komuna e Malishevës për pagesën e borxhit në shumën prej 2,050.00 euro.

Përmbaruesi në këtë rast me Urdhër për përmbarim P.nr.667/21 datës 03.06.2021 e lejon përmbarimin e propozuar nga ana e kreditorit mirëpo i debitori lartcekur në afat ligjor me dt.15.06.2021 me shkrim parashtron prapësim tek përmbaruesi ndaj Urdhrit të lartpërmendur, me të cilin ka theksuar se akti noterial – kontrata për shitblerjen e automjetit, në bazë të të cilit përmbaruesi ka lejuar përmbarimin, është akt noterial i cili përmban disa kushte, të cilat në afatet e caktuara me këtë kontratë nuk janë përmbushur nga ana e kreditorit, për shkaket e parapara nga neni 71 par.1 pika 1.3 i LPP-së, të cilat konsistojnë në atë se para dhe pas krijimit të këtij dokumenti noterial palët janë pajtuar që të mos e kërkojnë përmbarimin për një periudhë kohore

derisa objekti i këtij akti noterial- kontrata për shitblerjën e automjetit – automjeti me të dhënat si në kontratë, të lirohet nga ngarkesa-pengu nga zura e pengut- ARBK, kreditori nuk e ka përmbushur kushtin e përcaktuar më pikën 5 par.2 të kontratës për shitblerjen e automjetit lidhur me obligimin e shitësit A. P. se për çdo gjobë në komunikacion që figuron në emër të tij do ti kryej të gjitha obligimet me afat prej 30 ditësh, këtë kusht kreditori nuk e ka përmbushur edhe pas skadimit të afatit prej 30 ditësh debitori është i detyruar që me rastin e sigurimit dhe regjistrimit të automjetit ti paguaj të gjitha gjobat në emër të kreditorit-shitësit, gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave të refuzoj si të pa bazuar propozimin për përmbarim

Përmbaruesi privat i ka dërguar kreditorit prapësimin e debitorit, i cili është përgjigjur me datën 18.06.2021, për mes të cilës ka deklaruar se debitori në prapësimin e tij ka bërë një interpretim komplet të gabueshëm të titullit ekzekutiv- aktit noterial, kontratës së shitblerjes, kontrata është e qartë, është e përpiluar me profesionalizëm, në gjuhën shqipe dhe nuk ka material për keqinterpretim, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar.

Duke vlerësuar shkresat e lëndës e sidomos pretendimet e prapësimin të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të ushtruar nga kreditori, Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është **i pa bazuar**.

Sipas nenit 71 të LPP-së, të Ligjit nr. 04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 3 të datës 31.01.2013, më tej LPP), janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi e të cilat shkaqe po që se ekzistojnë, pengojnë përmbarimin e lejuar nga gjykata. Gjykata vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se pretendimet e tij janë të pa bazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, në fakt dokumenti mbi të cilin është mbështetur Urdhri mbi lejimin e përmbarimit ka titull ekzekutiv (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1), dokumenti përmbarues (titulli ekzekutiv) nuk ka humbur efektin e tij me ndonjë vendim tjetër institucional, (neni 71. Paragrafi 1 nën paragrafi 1.2) në bazë të cilit është marr me aktvendim përmbarues nuk është prishur, anuluar apo ndryshuar, shfuqizuar në një mënyrë të tjetër dhe nuk e ka humbur efektin e tij juridik, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3) palët për mes dokumentit përmbarues janë pajtuar që ti kryen obligimet e tyre për kohe të caktuar, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4) nuk ka skaduar afati kohor ku palët mund të kërkojnë përmbarimin, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5) objekti i përmbarimit nuk është i përjashtuar nga përmbarimi i detyrueshëm, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6) kreditori është i autorizuar që në bazë të dokumentit përmbarues të kërkojë përmbarimin kundër debitorit, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9) realizimi i kredisë nuk është shtyrë, ndaluar, ndryshuar ose parandaluar në ndonjë mënyrë tjetër në mënyrë të përhershme ose për periudhën e kufizuar kohore, si rezultat i ndonjë ngjarje që ka ndodhur në kohën kur debitori më nuk ka mundur të bënte të njohur në procedurë në të cilin është nxjerrë vendimi, respektivisht kredia është shuar pas lidhjes së një ujdie në Gjykatë ose në organin administrativ, (neni 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10) kërkesa nga dokumenti përmbarues nuk është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve, e sidomos duke pasur parasysh se lidhur me pretendimet nga kundërshtimi, debitori nuk ka ofruar asnjë provë të formës së shkruar që do të mbështetët pretendimet e tij, siç është paraparë në dispozitën e nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së, sipas dispozitës të cekur është paraparë se provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim për ndryshe prapësimi do të refuzohet.

Gjykata konstatoj se pretendimet e debitorit theksuar si më lart përkatësisht si në prapësim nuk qëndrojnë pasi Kreditori propozimit për përmbarim ja ka bashkangjitur aktin noterial- Kontratën e Shitblerjes së Automjetit LRP.nr.1323/2020 Ref: 2359/2020 dhe i plotëson kushtet

ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili thotë : “Propozimi për përmbajë kërkesën për përmbajë në të cilën do të tregohet dokumenti përmbajë origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbajë, kërkuesi i përmbajë dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbajë, objekti i përmbajë po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbajë”, sipas nenit 21 të LPP-së i cili thotë : “Organi përmbajë e cakton, përkatësisht e zbaton përmbajë vetëm në bazë të dokumentit përmbajë (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, sipas nenit 22 par. 1., pika 1.3., ku thotë : “ Dokumente përmbajë janë dokumenti noterial i përmbajë në pajtim me ligjin për noterinë”, prandaj pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë si të arsyeshme sepse prapësimi nuk ja ka bashkëngjitur as edhe një provë të vetme me shkrim, e sipas nenit 69 par. 4 i cili thotë: “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”, andaj mbështetur në këto gjykata një deklaram të tillë të debitorit nuk e aprovoi, pasi që kemi të bëjmë me aktin noterial- kontratën e shitblerjes të përpiluar pranë noterit i cili është titull ekzekutiv i bashkëngjitur propozimit për përmbajë, i cili i plotëson të gjitha kushte e parapara sipas nenit 22 par. 1., pika 1.3., të LPP-së.

Andaj në kuptim të nenit 5 par. 5, neni 21, neni 22 par. 1, nën par. 1.3, neni 26. par.1, nenet 37, 38, 69 paragrafi 4, si dhe nenet 71, dhe 73 paragrafi 3 të LPP-së, u vendos si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË-
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM –DIVIZIONI CIVIL
PPP. nr.1021/21, datë 12.12.2022**

**GJYQTARI
Betim Behluli**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.